



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 98. DATË 17. 05. 2018

“PËR

KRIJIMIN E KËSHILLIT VENDOR PËR SIGURINË PUBLIKE”

Në mbështetje të nenin 29 të ligjit 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”; pika 3/d e nenit 11, pika 2 e nenit 78 dhe nenit 79 të ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të shkresës me nr. 127/27 dt. 05.03.2018 e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjensisë për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore, të Urdhërit të Kryetares së Bashkisë nr. 29 datë 27.04.2018, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Ngritjen e grupit të punës për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Vendor për Sigurinë Publike me përbërje si vijon:
 1. Znj. Majlinda Bufi, Kryetare e Bashkisë
 2. Znj. Eleni Goga, Kryetare e Këshillit Bashkiak
 3. Z. Fatmir Davidhi, Shef i Komisarariatit Roskovec
 4. Z. Mariglen Rroko, Emergjencat Civile në Bashki
 5. Z. Elis Apostoli, Përgjegjës I Shërbimit Social në Bashki
 6. Znj. Manjola Vrapit, Koordinatore vendore kundra dhunës në familje
 7. Z. Eldison Hoxhaj , Oficeri i policisë për dhunën në familje
 8. Nga një përfaqësues i secilës parti politike me përfaqësim në Këshillin Bashkiak:
 - Z. Florand Kuka, përfaqësues i forcës politike PS
 - Znj. Ervisa Kaçeli, përfaqësues i forcës politike LSI
 - Z. Fredi Feleqi , përfaqësues i forcës politike PD
 9. Përfaqësues i Komuniteti Mysliman
 - Z. Hysni Merja
 10. Nga një përfaqësues i çdo komuniteti etnik:
 - Z. Aleksandër Sheme, përfaqësues i komunitetit Rom
 - Z. Artur Çerçizi , përfaqësues i komunitetit Egjiptian
 11. Përfaqësues të shoqërisë civile (që përfshijnë organizatat rinore, organizatat grave, media lokale, komuniteti I biznesit, organizata jo- qeveritare)



- Znj. Ronada Hoxha, përfaqësuese e organizatës “Gruaja, Komuniteti, Mjedi-Harmonizuar për zhvillim”
- Z. Besnik Sulejmani, përfaqësues i medias lokale

2. Miratimin e Rregullores mbi përbërjen, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Vendor për Sigurinë Publike.

KRYETAR
Eleni Goga





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

RREGULLORE

PËR

PËRBËRJEN, DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE MËNYRËN
E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT VENDOR PËR SIGURI
PUBLIKE



KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj Rregullore është përcaktimi i përbërjes, detyrave, përgjegjësive mënyrën e funksionimit të Këshillit Vendor për Siguri ngritur pranë Bashkisë Roskovec. Ky është një organ konsultues për çështje të sigurisë, që në bashkëpunim me policinë dhe institucione të tjera sigurie shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë, në të mirë të Bashkisë Roskovec.

Neni 2

Baza ligjore

1. Aktet kombëtare janë:
 - Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
 - Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 29/1;
 - Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, nenet 11/3 pika d dhe 78/2 dhe aktet nënligjore të dala për zbatim të tij.
 - Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Plani i veprimit;
2. Aktet ndërkombëtare janë:
 - Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut;
 - Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e amenduar;
 - Praktika të Mira për Ndërtimin e Partneritetit Polici-Publik, botuar nga OSCE (2008);

Neni 3

Përbërja

Këshilli Vendor për Siguri Publike përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

1. Kryetari i Bashkisë;
2. Kryetari i Këshillit Bashkiak;
3. Shefi i Komisarariatit të Policisë;
4. Drejtori i Emergjencave Civile në Bashki;
5. Përgjegjës I Shërbimit Social ;
6. Koordinator (Punonjësi) për dhunën në familje;



7. Oficeri i policisë për dhunën në familje;
8. Nga një përfaqësues i secilës parti politike me përfaqësim në Këshillin Bashkiak;
9. Nga një përfaqësues i secilës bashkësi fetare;
10. Nga një përfaqësues i çdo komuniteti etnik;
11. Përfaqësues të Shoqërisë Civile (që përfshin organizatat rinore, organizatat e grave, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe organizatat jo qeveritare).

Neni 4

Detyrat e Kryetarit të Këshillit

1. Kryetari i Bashkisë është kryesuesi i KVSP-së.
2. Kryesuesi i KVSP-së përgatit raportin për Këshillin Bashkiak mbi diskutimet, rezultatet, rekomandimet dhe vendimet pas çdo takim të KVSP-së.
3. Informon Këshillin Bashkiak dy herë në vit për aktivitetet e Këshillit Vendor për Siguri Publike;
4. Përcakton një person përgjegjës për të koordinuar për mbledhjet e Këshillit, përgatitjen e dokumenteve dhe shpërndarjen e tyre brenda 5 ditë pune si dhe mbajtjen e minutazhit të diskutimeve.
5. Mbledhjet e KVSP-së janë të hapura.

Neni 5

Mandati i anëtarëve të Këshillit do të zgjasë aq sa edhe mandati i Kryetarit të Bashkisë.

Neni 6

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Rritja e ndërgjegjësimit të banorëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin vendor;
2. Përgatitja e planit dhe zhvillimit të projekteve vjetore të punës në mënyrë që të rritet dhe për të përmirësuar sigurinë në komunitet, i cili i paraqitet Këshillit të Bashkisë për miratim;
3. Identifikimi i problematikave të cilat rrezikojnë sigurinë e komunitetit dhe rekomandimi për hartimin e një Plan Veprimi;
4. Bashkëpunimi me Drejtorinë Rajonale të Policisë dhe institucioneve të tjera për të parandaluar veprimet të cilat rrezikojnë sigurinë e komunitetit;
5. Të kërkojë nga OJF apo Organizata Qeveritare financim të projekteve lidhur me sigurinë e komunitetit;
6. Të ftojë në mbledhjet e tij aktorë apo përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit;
7. Të kërkojë nga Drejtoria e Policisë të përgjigjet për rastet e rëndësishme që lidhen me sigurinë në bashkësi, pa ndërhyrë në hetimet e saj;
8. Të organizojë mbledhjet minimalisht një herë në dy muaj;

Neni 7

1. Mbledhjet e KVSP-së përcaktohen dhe kryesohen nga Kryetari i Bashkisë. Kryesuesi i KVSP-së thërret mbledhjet dhe përkujdeset për caktimin e rendit të ditës në konsultim me anëtarët e KVSP-së.



2. Mbledhjet e Këshillit mund të thirren edhe me kërkesën e shumicës së anëtarëve të Këshillit si mbledhje të jashtëzakonshme.

Neni 8

1. Këshilli zhvillon punën e vetë në bazë të rendit të ditës, të miratuar nga anëtarët e këshillit të KVSP-së.
2. Procesverbali që mbahet në takimet e KVSP-së, futet në dosje dhe duhet të jetë i disponueshëm për anëtarët e Këshillit Bashkiak, sipas nevojës dhe kërkesës. Një kopje e procesverbalit i dërgohet edhe Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Neni 9

Këshilli Vendor për Siguri Publike mund të mbajë mbledhje, nëse në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillit, përkatësisht nëse për rekomandimet e propozuara votojnë shumica e të pranishmëve. Në rast të rezultatit të barabartë të votimit, vota e kryesuesit është vendimtare.

Neni 10

1. Në mbledhjet e Këshillit, diskutimet për çështjet e shtruara sipas rendit të ditës dhe çështjet tjera me interes për siguri të komuniteteve mund të zgjasin 5 minuta.
2. Çdo anëtar i tij ka të drejtë që për të njëjtën çështje të diskutojë vetëm një herë.
3. Në rast se ndonjëri prej anëtarëve të KVSP-së, dëshiron të bëjë replikë lidhur me diskutimin e një anëtari tjetër të KVSP-së, replika nuk mund të zgjasë më shumë se 2 minuta.

Neni 11

Rregullat e mbledhjes

1. Anëtarët e Këshillit, nuk duhet ta ndërpresin fjalën e kryesuesit të mbledhjes ose të diskutuesve të tjerë, të përdorin fjalë ofenduese, të ndërmarrin sulme personale apo veprime ndaj ndonjë anëtari, të përhapin informacione që cenojnë jetën private të çdo anëtari, të sillen në mënyrë të padenjë ose të shkaktojnë rrëmujë në mjediset ku mbahet mbledhja e KVSP-së.
2. Në mbledhje nuk duhet të diskutohet për çështje apo problematika që nuk i përmbahen qëllimit të kësaj rregullore.

Neni 12

Masat disiplinore

Masat disiplinore që mund të ndërmeren për anëtarët që shkelin nenin 11 të këtij akti janë:

- a. Tërheqje e vëmendjes;
- b. Vërejtje;
- c. Marrja e fjalës;
- d. Përrjashtim nga seanca e mbledhjes.



Neni 13

Gjuhët e përdorura

Mbledhjet e Këshillit mbahen në gjuhën shqipe, duke siguruar përkthimin e përshtatshëm, sipas nevojës edhe në gjuhët e komuniteteve tjera.

Neni 14

Dispozitat kalimtare

1. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë Rregullore do të bëhen sipas procedurës së nxjerrjes së saj.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Bashkiak Roskovec.

KRYETAR

Eleni Gogaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 39, date 17/05/2018

“PER PERBALLIMIN NGA BASHKIA ROSKOVEC TE SHPENZIMEVE PER REGJISTRIMIN E PASURIVE TE PALUJTSHME (TRUALL) PER FAMILJET QE DO APLIKOJNE PER STRHIM ”

Ne mbeshtetje te ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore“, Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne RSH”, te ligjit 68/2017 “Per financat e veteqeverisjen vendore“, Udhezimi nr.2 date 6.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”, i ndryshuar, te VKB nr.76 date 22.12.2017 “Per miratimin e buxhetit dhe numrin maksimal te punonjesve te Bashkise Roskovec per vitin 2018”, keshilli i bashkise ;

V E N D O S I:

1. Miratimin e fondit prej 120,000 leke per perballimin e shpenzimeve per regjistrimin e pasurive te palujtshme per 20 familjet e NJA Strum ,Kurjan dhe Kuman per shkak te pamundesise financiare te ketyre familjeve per keto shpenzime.

Gr.	Tit.	Kap.	Art.	Shuma leke
00	01110	5	602	120,000

2. Ky fond te perballohet nga fondi I miratuar ne buxhetin e vitit 2018 ne zerin : “Shpenzim per regj. te pasurive te palujtshme”.

Gr.	Tit.	Kap.	Art.	Shuma leke
00	01110	5	602	120,000

KRYETAR

Eleni GOGA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 40 .DATE 17.05 .2018

“PËR MIRATIM TË NDËRMARRJES SË NISMËS PËR HARTIMIN E DOKUMENTEVE TE PLANIFIKIMIT NË NIVEL VENDOR”

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” neni 23 pika 14, në ligjin 107/2014, datë 1.10.2014 ”Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, neni 12 pika 2/a dhe neni 13 pika 1/b; me ligjin 73/2015, date 9.7.2015 dhe VKM nr 686, date 22.11.2017,”Per miratimin e rregullores se planifikimit te territorit”,Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

Miratimin për ndërmarrjen e nismës për hartimin e dokumenteve të planifikimit në nivel vendor (Planit të Përgjithshem Vendor)

Nisma e ndërmare do t’i hapë rrugë të gjithë procesit të hartimit të PPV, në përputhje të plotë me të gjitha procedurat e parashikuara nga ligji, duke filluar me:

- a) **Analizë të fakteve që çojnë në nevojën për hartimin e dokumentave të planifikimit në nivel vendor dhe problemet që do të trajtohen nga ky instrument;**
- b) **Kufijtë e territorit që do të studiohet të cilat do të paraqiten në sistemet e gjeoreferimit, dhe në shkallë jo më të vogël se 1:5000**
- c) **Planin e veprimit në formën e grafikut, për proceset e hartimit e të bashkërendimit, pjesmarrjen apo sipas rastit edhe ndërmjetësimin**
- d) **Koordinimin mes institucioneve publike dhe alokimin e burimeve njerëzore të nevojshme për hartimin e dokumenteve të planifikimit në nivel vendor.**

